



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:057798

Datë: 09.12.2021

Numri i dokumentit: 02492962

PS.nr.32/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Special, në trupin gjykues të përbërë nga Kryetari i trupit gjykues Gjyqtarët Kujtim Krasniqi, anëtarët – gjyqtarët profesional, Mentor Bajraktari dhe Lutfi Shala, me zyrtaren për bashkëpunim profesional Luljet Gashi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. P nga Istogu, për shkak të veprave penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së. sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Kosovës, me numër PPS.nr.28/2019 të dt.29.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor–të hapur për publikun, e me dt. 22.11.2021, bie dhe pa prezencën e palëve shpall publikisht, ndërsa me dt.09.12.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

A. P., nga i ati J, dhe e ëma Gj, e gjinisë B, i lindur me dt..., në fshatin Gj, K. Istog, ku edhe jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, me nr.personal:....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga dt....., deri më dt.....

**Konform nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së,
LIROHET NGA AKUZA**

S e p s e:

Me dt..... në ora 01:26 min në P. me qëllim të frikësimit serioz i është kanosur të dëmtuarit-zyrtarit të konsullatës në K.. e A... në P.. A.Ç në atë mënyrë që pasi paraprakisht me dt..... në ora 13:41 i pandehuri përmes numrit të telefonit të tij mobil 045/848-085 i dërgon SMS të dëmtuarit A.Ç.në numrin e tij të telefonit në gjuhën Gjermane duke i kërkuar nga i njëjti që t’ia siguroj një dokument udhëtimi dhe mjete materiale me qëllim të udhëtimit në Austri dhe pasi që i dëmtuari nuk është përgjigj në telefon në natën kritike i pandehuri përmes aplikacionit Whats App në gjuhën Gjermane i dërgon një SMS me përmbajtje kërcënuese “unë do të zhdukë nga faqja e dheut popullin tuaj nëse ti pretendon me ju kundërvu presidentit atëherë unë do të ju djegë të gjithëve bushtër.

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.

-Pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari : A. Q.ka heq dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Arsyetim

Historiku i procedurës,

Prokuroria Speciale e Republikës Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr.28/2019 të dt.29.07.2020, të kundër të akuzuarit A.P, për shkak të për shkak të veprës penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa duke vepruar sipas kërkesës së gjykatës për plotësimin dhe korrigjimin e aktakuzës, e ka ndryshuar vetëm kualifikimin juridik duke shtuar se i pandehuri ka kryer veprën penale nga neni 167 par.4 lidhur me par.3 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt:29.03.2021, duke vazhduar me shqyrtime Gjyqësore- nga dt:10.11.2021 në të cilin shqyrtim PSRK ka bërë përsëri Kualifikim juridik vetëm sa i përket paragrafit 3 të nenit 167 të cilin paragraf e ka hequr nga kualifikimi juridik ndërsa ka mbetur pran kualifikimit juridik vetëm për veprën penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, seanca ka vazhduar edhe dt:20.11.2021 ndërsa me dt:22.11.2021 kur edhe është bërë shpallja e aktgjykimit, në të cilat shqyrtime kanë prezantuar nga PSRK prokurorja Florie Shemolli, i akuzuari A.P me mbrojtësen Av.Teuta Beka Bunjaku e caktuar sipas detyrës zyrtare, i dëmtuari A.Ç.

Fjala Hyrëse.

PSRK në fjalën hyrëse nder te tjera ka deklaruar: se nga provat të cilat do të vërtetohet në shqyrtimet kryesore siç është deklarata e të dëmtuarit A. Ç, si dhe provat tjera materiale të përkthyer në gjuhën shqipe pastaj dekreti i të dëmtuarit, raporti i ekspertizës së spitalore, pas dëgjimit të gjitha këtyre gjykata do të bindet se i akuzuari e ka kryer veprën penale të cilën ngarkohet, dhe do të dënoj me dënim sipas ligjit.

I dëmtuari në fjalën hyrëse nder te tjera ka deklaruar se: se unë në këtë rast nuk ndihem i dëmtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av.Teuta Beka Bunjaku e caktuar sipas detyrës zyrtare fjalën hyrëse nder te tjera ka deklaruar se: konsideroj se meqenëse në seancën e kaluar është bërë kualifikimi i veprës penale nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 kur Prokurorja e rastit ka hequr piken 3 të nenit 167 konsideroj se kjo nuk përputhet me veprën që është prezent i akuzuari pika 1 dhe 2 i nenit 4 thotë që kushdo që e privon nga jeta personin, kisha kërkuar edhe një herë të ri kualifikohet vepra penale, pasi që më shumë përshtatet pika 5. Ashtu siç u deklarua edhe eksperti në këtë seancë se i pandehuri nuk ka qenë fare në institutin e mjekësisë gjatë kohës kur ju është caktuar masa e paraburgimit, ashti siç e parashih KPRK-së, që me kërkesën e prokurores të paraqitet edhe propozimi për caktimin e ndonjëres nga masat për kryesit për çrregullime mendore.

I akuzuari A.P në fjalën hyrëse nuk ka dashur të deklarohet.

Konstatimet e Gjykatës.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun, procedimit të provave personale e materiale, dëgjimit të dëshmitarit, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: nuk është provuar se i akuzuari A.P, ka kryer veprat penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së., për të cilat është akuzuar për arsyet të cilat gjykata do të shtjelloj në vijim të arsyetimit në vlerësim të provave personale dhe materiale..

Provat personale:

- Dëshmia e dëshmitarit/dëmtuarit A.Ç
- Deklarimi I Ekspertit psikiatër dr.J. Z.

Provat materiale:

- Mesazhet e përkthyer në gjuhën Shqipe të datës 05.05.2019 dhe 06.05.2019 të nxjerra nga telefoni i të dëmtuarit A.Ç të cilat mesazhe në aplikacionin “Ëhatsapp” në numrin e tij të telefonit i kishte pranuar nga tani i akuzuari A.P;
- Dekreti i A.Ç ref.nr.54/17 i datës:15.02.2017, i lëshuar nga Ministria e Punës së Jashtme të Republikës së Kosovës;
- Raporti i ekspertizës nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me numër të protokollit 189/2 i datës:13.07.2020, për ekzaminim psikiatrik të tani të akuzuarit A.P.

Deklarimi I ekspertit psikiatër

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të Av **Teuta Beka Bunjaku ka ftuar dhe ka dëgjuar mendimin e** Ekspertit psikiatër dr.J. Z. në lidhje me aftësinë e të pandehurit për ta kuptuar gjykimin, I cili në seancën e dt:20.11.2021 ka deklaruar jam njeri prej anëtareve të cilët e kanë bërë vlerësimin psikiatrik për të pandehurin A.P, qëndroj në tërësi prapa kësaj ekspertize, mbetem në tërësi me mendimin e dhënë të dt.12.07.2020, sa i përket gjendjes dhe vlerësimit për veprën penale për të cilën ka qenë i akuzuar, dhe se pas konsultimit të drejtpërdrejt me të për periudhën lidhje me pjesëmarrjen në seancë i njëjti mund të merr pjesë në seancë gjyqësore, mund të konsultohet me mbrojtësin e tij, dhe deklaratat e tij të dhëna mund të jenë valide.

Gjykata me aktvendim në procesverbal ka konstatuar se i pandehuri është i aftë ti nënshtrohet gjykimin, është i aftë të kuptoj gjykimin në tërësi, mund të konsultohet me mbrojtësen dhe deponimet e tij në këtë shqyrtim janë valide.

Dëshmia e dëshmitarit

Dëshmitare A.Ç, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.20.11.2020, ndër të tjera ka deklaruar se ka dhënë dy deklaratat në stacionin policor me datë 07.06.2019, dhe në prokurori me datë 15.08.2019 dhe qëndron prapa atyre deklaratave. Me tej thekson se punon në konsultën e Austrisë në Pejë me honorar, dhe ka kompaninë e tij, Ç. Gj. I. I njëjti shton se datat nuk i kujtohet kur ka qenë në konsultën e A., por sa i kujtohet dhe nëse nuk gabon ka qenë ditë e diel ka qenë në shtëpi, dikun në mesditës e ka marr një telefonatë që në fillim e ka shpërfill sepse ishte ditë vikendi, ndërsa rreth orës 7 e ka marr prapë, dhe meqenëse s’është numër zyrtar e kanë obligim që telefonatat insistuese me i pranuar, meqenëse nuk dihet arsyeja e telefonatës, mund të jetë ndonjë qytetar i A. i cili është me vizitë në Kosovë dhe mund të ketë ndonjë urgjencë ndërsa numri i tij zyrtarë është,, ndërsa personi që e ka thirre në telefon ju ka prezantuar me një emër si “Bullgar”, për shkak se përfundojke me I... ose i ngjashme e që nuk është i sigurt, fliste në gjuhën Gjermane, ndërsa kur personi gjuhën anëtare nuk ka Gjermane, vërehet lehtë për shkak të shqiptimit të germave gjatë fjalëve, për vetë atë ka qenë një indikacion se ky vjen nga vendet e ish Lindjes por mund të jetë edhe nga hapësira e pjesës Gjermane të Zvicrës. Me tej ka theksuar se kërkesat e tij ka qenë konfuzë së pari ka thënë se i duhet patjetër një pasaportë për të udhëtuar në Austri, i njëjti e ka pyetur nëse është shtetas i Austrisë, ka thënë se është shtetas i Austrisë, i ka kërkuar që ti i’a dërgoj të dhënat personale, dhe me këtë rast i lëshohet një pasaportë emergjente pasi shtetasi i Austrisë mund të udhëtoj në shtetin e vetë. I njëjti shton se biseda e tyre ka zgjatë gjatë, pasi që tha nuk jam shtetas i Austrisë por jam, shtetas i Zvicrës, nga ai moment nuk e ka marr më seriozisht, sepse i ka thënë se është i zënë peng në Kosovë, natyrisht se kjo ka qenë një gjë që duhet ta marr seriozisht dhe është detyruar me regjistrua si fenomen kushtimishtë, ka kërkuar që mundësisht të kërkoj policinë, ia ka treguar edhe numrin, madje ka filluar se policia e kanë rrah ja kanë thyer këmben et... dhe nga ai moment ka insitu ta përfundojë

bisedën në mënyrë paqësore, dhe ka ardhur në përfundim se personi nuk jep shenja të një rehabilitimi psikik të momentit. I njëjti ka theksuar se ne jemi përshëndet në mënyrë paqësore me ditë të mirë, por dikun pas orës 1 e 30 mn. pas mesnate i ka ardhur një sms përmes aplikacionit Whats App, për të cilin është njoftuar përmes akterëve të sigurisë, të cilin e kanë njoftuar se ju ka ardhur një sms në Whats App, natyrisht që në mëngjes e ka kontaktuar ambasadën dhe personat relevant që kujdesën për sigurinë e Konsullatës të Austrisë dhe është marr një mendim i përbashkët që rasti duhet të ndiqet sepse situata në atë kohë ka qenë fragjile, sa i takon sigurisë globale dhe natyrisht prej eksperteve ka mësuar që nuk bënë asnjë rast të neglizhohet sepse nëse nuk njihet personi nuk dihet kush qëndron prapa tij. Me tutje shton se gjatë bisedës së mëhershëm i njëjti ka deklaruar që është ftuar nga presidenti i Austrisë që ja dinte edhe emrin çuditërisht, dhe atë nuk e ka marr seriozisht se nëse presidenti i Austrisë e fton dikën ne jemi institucioni i parë që e kupton. *Mirëpo atë tekstin në sms që e ka dërguar janë një mori fjalësh, një nder to ka qenë se unë do të fus zjarrin, do të ju zhdukë nga faqja e dheut, popullin tuaj nëse ti pretendon me ju kundërvu presidentit atëherë unë do të ju djegë të gjithëve bushtër.* I njëjti tutje shton se gëzon imunitet të plotë diplomatik, ndërsa të nesërmen e ka kuptuar kur policia ka arritur ta lokalizojë në bazë të telefonit, meqenëse nuk jetojnë larg njeri tjetrit në rrugë private i ka interesuar kush është dhe e ka pasur ide me kon po fletë, i njëjti ka ardhur në përfundim se ky nuk e ka njohur dhe nuk e ka ditë me kon fletë, po ashtu ka ndier keqardhje për gjendjen e tij shpirtërore, dhe flitej për gjendjen e tij shpirtërorë dhe shëndetësore sepse edhe atë ditë ka qenë në ndikim të alkooli apo substance tjetër dhe ky është mendimi i tij personal. Nder tjera i njëjti ka thekuar se a është ndjere i kanosur edhe po edhe jo, në mjedisin ku jeton është mjedis ku jeton brenda vëllezërve, dhe personalisht dhe fizikisht nuk është ndier i kërcënuar, përndryshe ka deklaruar se nuk është i dëmtuar në seancën e kaluar, se këto procedura janë që duhet të ndiqen dhe është dashur detyrimisht të ndiqen këto procedura, vetë ai edhe me deshtë mi ndal këtë procedurë nuk mundet mi ndal sepse janë instancat tjera që vendosin, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori ka kërkuar që personi të mos ndiqet penalisht dhe këtë vetë e ka bërë në personelin e sigurisë së ambasadës. Me tej ka theksuar se vetë ka deklaruar edhe atje se nuk është i rrezikshëm ky person, i njëjti rikujton përkatësisht edhe në prezencë të ambasadës ka kërkuar që ti ofrohet një trajtim i mirëfilltë këtij personi, ka përsëritur edhe në seancën gjyqësorë të njëjtën kërkesë. I njëjti ka shtuar se e ka lajmëruar për mesazhin dikush tjetër në telefonin e tij por nuk mund të thotë se është zbulim i sekretit zyrtar, dhe numri i lartcekur ka qenë numër i tij personal, e këtë numër ja ka ofruara konsullatës, ky numër të jetë në shërbim i njëjti numër ka qenë në tabelën informative të konsullatës, ku kanë qasje edhe qytetarët dhe është edhe në faqen zyrtare të konsullatës ndërsa vetë mendon se pasi ka qenë telefon publik për ambasadën mesazhi i është drejtuar konsullatës pasi qe vetë atë nuk e ka njohur dhe nuk i është drejtuar personalisht sepse biseda me të është bërë në gjuhën gjermane dhe ai nuk e ka pas idenë që vetë është me rrënjë shqiptare, dhe niveli i gjuhës është në nivel akademik dhe nuk ka pas mundësi me vërejt këtë, se pas pranimit të sms dhe konsultimeve edhe me stafin tjetër e kanë parë të arsyeshme me lajmërua rastin se dikush fshehët prapa këtij personi, pra si konsullatë, ata janë ndje të rrezikuar përndryshe nuk e kishin iniciuar rastin mirëpo për vetë ai nuk qëndron, por pasi ka kaluar në një instancë tjetër, dhe mund të involvohen të gjitha akterët e ambasadës duke përfshi konsujt e tjerë, duke përfshi ministren e punëve të brendshme të Austrisë. I njëjti ka theksuar se lidhur me kërcënimet ka qenë rasti i parë dhe i vetmi deri me tani, ndërsa veprimet e konsullatës kanë qenë për faktin se situata globale ka qenë fragjile por edhe të mos ishte ashtu do të procedohej njëjtë, ndërsa kërkesa e tij është qe i akuzuari dhe si rezultat i komunikimit të akterëve të sigurisë brenda konsullatës që këtij personi ti ofrohet trajtim i nevojshëm dhe të të mos ndiqet penalisht, dhe për këtë mendon se ka të drejtë edhe të deklarohet, kurse është konsull në mandatin e dytë ka shtetësinë e Austrisë ndërsa në Kosovës ka leje qëndrim dhe letërnjoftim me vendbanim primar. I njëjti ka shtuar se organet e sigurisë i besojnë dhe vetë është në harmoni të plotë me ato organe, kurse më vonë e ka kuptuar se e njëj

personin kush është familjarisht meqenëse janë me një distancë 5 km, ndërsa personalisht vetë, nuk ndjej ndonjë rrezik, nga ky person pasi tani ia njef edhe familjen dhe ky i takon një familje të ndershme, konsideron se nuk ka asnjë rrezik nga ky person. E si përfundim i njëjti ka shtuar se konsullata nuk është e interesuar q ky person te ndiqet penalisht pasi këto institucione nuk ndjen rrezik nga ky person.

Deklarimi I ekspertit psikiatër lidhur me ekspertizën

Ekspertit psikiatër dr.J.Z. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.20.11.2020, ndër të tjera ka deklaruar se "citata" qëndroj prapa ekspertizës së dt.12.07.2020 të cilën e kemi bërë grupi i eksperteve ashtu që ne si ekip vlerësuese duke u bazuar në të dhënat e heteroanestike, shikimin e dokumentacionit që gjendet në shkresat e lëndës, ekzaminimin ambulator, analiza e rasteve të ngjashme dhe konsultimi i literaturës në bazë të këtyre të dhënave kemi ardhë në përfundim se i ekzaminuari ynë vuan nga çrregullim mendor dhe çrregullimi i sjelljes i përdorimit të substancave psiko-aktive, çrregullim ky që kodohet me F19 dhe çrregullimi i personalitetin i pa specifikuar, në momentin e kryerje së veprës për të cilën akuzohet i ekzaminuari ynë nuk ka qanë në gjendje të intoksikimit akut, apo apstencës kështu që aftësia për të kuptuar veprime te vetë ka qenë zvogëluar por jo esencialisht, që do të thotë se i njëjti ka qenë përgjegjës për veprimet që i ka marr ne jemi bazuar edhe në trajtimin e mëhershëm që i njëjti ka qenë në institucion e psikiatrisë forenzikës për trajtim, shton se gjatë kohës që qëndrimin në IFK, ka pas të caktuar në masë të trajtimit të detyrueshëm në ndalim tek ne ka qëndruar disa muaj, gjatë kësaj kohe dhe në momentin kur është liruar ka qenë në gjendje stabile. Ndërsa para se ti ndryshohet masa ne kërkojmë që masa e trajtimit të detyrueshëm në ndalim në liri udhëzojmë që ai të trajtohet në qendrat e shëndetit rajonale të cilat janë përgjegjës për mbikëqyrjen kësaj mase, dhe mandej më nuk kemi kompetenca.

Tutje deklaron se ne në IPFK veprojmë si ekip multidisciplinare për trajtimin e rasteve të cilat kanë të shqiptuar masën për trajtim psikiatrik në ndalim ne qasemi si ekip, ku pjesë e epikës është psikiatri, psikologu, punëtori social dhe stafi mbështetës. Ne vlerësimin për ndryshimin e masës së trajtimit nga ajo më ndali në liri e bëjmë në bazë të vlerësimit të gjendjes dhe përmirësimit të klientit gjatë kohës së qëndrimin në institucion po ashtu si instrument matës është edhe vlerësimi i rrezikut që i njëjti ti përkasin për të cilat ka qenë i akuzuar më parë, pra bënë teste të vlerësimit që quhen PCR20, po ashtu pjesë e rëndësishme e trajtimit të këtyre rasteve është edhe përfshirja e familjes në këtë trajtim dhe për mbështetjen që do të ja jep klientit pasi që të lihet nga IPFK-ja, po ashtu në institucion punohet edhe në përmirësimin e konklucës që i njëjti duhet të e përdorë terapinë e përshkruar nga profesionist të shëndetit mendor pra janë disa hallka të trajtimit, që vlerësohen nga ekipa multidisciplinare kur behet ndryshimi i masës ndërsa sa i përket trajtimit të rastit konkret ne nuk kemi kërkuar ndonjë masë të trajtimit pasi që kemi vlerësuar se i njëjti është përgjegjës për veprimet e tij, mirëpo në par. E fundit të ekspertizës ne kemi sugjeruar dhe orientuar që i njëjti ka nevojë të trajtohet dhe ky trajtim duke pas parasysh se i nijetin probleme sa i përket përdorimit të substancave është në vullnetin që dëshiron të trajtohet apo nuk dëshiron ne edhe për këtë arse ne kemi sugjeruar që i njëjti te këtë trajtim medikamentoz simptomatik, në bazë të simptomave dhe rehabilitim psiko-social me qëllim të motivimin në drejtim të ndërprerje së abuzimit me substanca andaj këtë trajtim mund ta merr në mënyrë të ndryshme. Dhe nuk e kemi kërkuar ndonjë masë, sa i përket rrezikut për përsëritjen veprave të tilla aktualisht mendoj që i njëjti duhet të ketë konsulta me mjeket psikiatër në mënyrë që rreziku të jetë më i vogël për përsëritje e veprave të tilla, nëse ai përmbahet këshillave mjekësore dhe i njëjti e ndërpre abuzimin me substanca psikoaktive rreziku duhet të jetë më i ulët për përsëritjen e veprave të tilla. Sa i përket përdorimit të substancave personat në fjalë dhe personat tjetra kanë njohuri të mjaftueshme për përdorimin e këtyre substancave, dhe mund të gjykojnë për e këto vepra që bien ndesh me ligjin.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari **A.P.**, pas njoftimit me të drejtat e tiji njëjti e ka shfrytëzuar të drejtën e heshtjes.

Fjala Përfundimtare e palëve.

Prokurorja e Prokurorisë Speciale fjalën përfundimtare e ka Deklaruar “citat; nga provat e prezantuar në shqyrtimin e sotëm dhe pas dëgjimit të dëshmitarit A.Ç.si dhe provat tjera materiale siç është mesazhet e përkthyer Mesazhet e përkthyer në gjuhën Shqipe të datës 05.05.2019 dhe 06.05.2019 të nxjerra nga telefoni i të dëmtuarit A.Ç të cilat mesazhe në aplikacionin “Whatsapp” në numrin e tij të telefonit i kishte pranuar nga tani i akuzuari A.P, Dekreti i Z.A.Ç ref.nr.54/17 i datës:15.02.2017, i lëshuar nga Ministria e Punës së Jashtme të Republikës së Kosovës, Raporti i ekspertizës nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me numër të protokollit 189/2 i datës:13.07.2020, për ekzaminim psikiatrik të tani të akuzuarit A.P dhe pas dëgjimit të ekspertit në mënyrë të qartë u vërtetua se i akuzuari A.P.ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet dhe atë Rrezikimin...në këtë seancë dëgjuam edhe ekspertin në mënyrë të qartë deklaroi se i akuzuari A.P është në gjendje ti kuptoj veprimet e tij andaj nuk lirohet nga përgjegjësia penale mirëpo gjithashtu në raportin e ekzaminimit se i njëjti ka qenë m përgjegjësi të zvogëluar por jo esencialisht. Andaj mbi bazën të gjitha këtyre i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, i propozoj gjykatës që si dënim plotësues të njëjti ti shqiptoj masën e trajtimit psikiatrik të detyrueshëm psikiatrik në liri për aq kohë sa gjykata mendon, për shkak se ekziston rreziku se i njëjti mund të përsëritë ndonjë vepër tjetër penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit Av .Teuta Beka Bunjaku, fjalën përfundimtare ka deklaruar; citat: duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe ekspertizën IPFK-së të dt.12.07.2020,m deklaratës së ekspertit në këtë seancë konsiderojnë se i pandehuri është i njohur për prokurorinë se i njëjti vuan nga çrregullimet mendore që ceket në ekspertizë dhe gjatë kërkesës së prokurorisë për çfarëdo mase është dashur të paraqitet edhe propozimi për caktimin masave që i parasheh ligji sipas neni 52 të KPRK-së, dhe në këtë rast konsiderojnë se ka pas shkelje procedurale, meqenëse në këtë seancë gjyqësore e dha dëshminë edhe dëshmitarit me të cilin deklaroi se sikurse në deklaratën e dhënë në prokurori në kohën kur ka ndodhë vepra penale se i njëjti tërhoq nga ndjekja penale pas konsultimit me ambasadën e Austrisë dhe meqenëse i pandehuri nuk ka pas dashje, dijani për kryerjen e kësaj vepre, dhe nuk e ka njoftë palën e dëmtuar, konsideroj se nuk janë formuar elementet qenësore të veprës penale, dhe i propozoj gjykatës që në këto rrethane dhe në këtë rast dhe ndaj të pandehurit të jepet Aktgjykim Lirues.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare nuk ka dashur të deklarohet.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata sjellë në vëmendje se, përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t’iu nënshtuar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë, organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtuara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal. Legjislacioni duke konkretizuar parimin e ligjshmërisë të shprehur në nenin 2 të KPRK-së, në pjesën e posaçme të Kodit Penal, ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse të dënimeve për to. Sipas të drejtës sonë penale, e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure

të caktuar veprë penale, të parashikuar nga ligji penal. Për këtë arsye, bashkë ekzistenca e njëkohshme e elementeve të figurës së veprës penale ka një rëndësi të madhe sepse lidhet domosdoshmërisht me zbatimin e parimit të ligjshmërisë.

Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e njëkohshme e të gjithë elementëve përbërës të saj. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer dhe kryesi i saj mbanë përgjegjësi penale kur ekzistojnë në tërësi elementët e saj. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Për këtë arsye detyrë e çdo gjykate, është verifikimi i ekzistencën së njëkohshme të të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi i sjellë si i pandehur para një gjykate nuk mund të dënohet, andaj gjykata në rastin konkret ka marrë aktgjykim lirues pasi që nuk është provuar se I akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata sjellë në vëmendje se, barra e të provuarit, se i pandehuri është fajtor për veprën penale, i përket prokurorisë ashtu që prokuroria është e obliguar që të vërtetoi me prova, se ekziston përtej dyshimit mirë të bazuar, se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet. Në aspektin procedural penal, i akuzuari mbulohet nga parimi i prezumimit të pafajësisë si dhe parimi In Dubio Pro Reo (*Mëdyshjet lidhur me provat dhe faktet si dhe zbatimin të ligjit zbatohen në favor të të pandehurit*), po ashtu i akuzuari nuk është i detyruar që ta provoj fajësinë apo pafajësinë e tij, ndërsa në këtë proces penal akuzuari e ka zgjedh të drejtë e heshtjes duke mos dashur të deklarohet për çështjen si dhe nuk ka propozuar prova për në interes të mbrojtjes së tij. Po ashtu, edhe pse dispozita e nenit 329 par.4 të KPPRK-së, e parashikon të drejtën e Gjykatës që “ *Përveç provave të propozuara nga palët dhe i dëmtuari, trupi gjykues ka të drejtë të shqyrtojë provën që e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale*”, kjo dispozitë procedurale nuk e kthen gjykatën në palë, për të siguruar prova, në procesin penal sepse në të kundërtën do të shkelet parimi i paanshmërisë dhe do të zhveshët nga autoriteti që realizon dhënien e drejtësisë dhe do të merr rolin e autoritetit ndjekës, andaj gjykata nuk ka vlerësuar të domosdoshme dhe të nevojshme për të marrë prova shtesë për ndriçimin e gjendjes faktike pasi që ka konsideruar se provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësorë kanë qenë të mjaftueshme për vërtetimin e drejtë të plotë të gjendjes faktike.

Që i akuzuari të gjendet fajtor nga gjykata, duhet të provohet se aktakuza e ngritur nga prokuroria është e provuar dhe argumentuar përtej dyshimit të bazuar mirë, e që në rastin konkret prokuroria nuk ka mundë ta bindë gjykatën se me provat e propozuara dhe administruar në shqyrtim gjyqësor i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet sipas aktakuzës. Prezumimi i pa fajësisë dhe barra e të provuarit janë kërkesa imperative dhe të artikuluar në të gjitha të drejtat dhe konventat ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, e të cilat janë inkorporuar në nenin 3 të KPPRK-së (*Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe Parimi In Dubio Pro Reo*) dhe nenin 7 par.1 të KPPRK-së, që nënkupton detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, këto konstatime gjejnë mbështetje në nenin 11 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 6 par.2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut , neni 14 par.2 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, andaj Gjykata bazuar në detyrimet ligjore duke vepruar në zbatimin e drejt dhe të saktë të dispozitave ligjore si dhe me bindje të lirë i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit A.P. nuk është provuar përtej dyshimit mirë të bazuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës PPS.nr.28/2019 të dt.29.07.2020, i pandehuri **A.P** është sjellë për gjykim për shkak të veprës penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së

Sipas përkufizimit ligjor të nenit 167 par.4 të KPRK-së veprën penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare kryen : “1. Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin nën mbrojtje ndërkombëtare, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. Ndërsa paragrafi 4 i nenit 167 të KPRK-së ka përcaktuar se veprën penale sipas këtij paragrafi e kryen: “Kushdo që bën kanosje serioze se do të kryejë vepër penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet. ”, pra, sipas paragrafit 4 konsumohen elementet e veprës penale po qese personi me dashje e me qëllim bën kanosje serioze me qëllim ta privon nga jeta, dhe kur akti i tillë ka gjasë të rrezikojë personin ose lirinë e tij.

Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është parashikuar nga Kodi ynë Penal në Pjesën e posaçme të tij, në Kapitullin XV, të titulluar: *“veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare”*. Sipas përkufizimit ligjor, kjo dispozitë merr në mbrojtje ato marrëdhënie juridike të vendosura me ligj, për të siguruar mbrojtjen e personave me mision ndërkombëtar dhe e interesat dhe të drejtave të ligjshme të shtetit, shtetasve, shtetasve të huaj dhe personave me mision ndërkombëtar e të cilët janë nën mbrojtje ndërkombëtare sipas nenit 113 të Kodit penal të Kosovës si dhe konventës ndërkombëtare për parandalimin dhe ndëshkimin e veprave kundër personave nën mbrojtje ndërkombëtare.

Sipas nenit 113 par.4 të KPRK-së Person nën mbrojtje ndërkombëtare ose person i mbrojtur ndërkombëtarisht - nënkupton:

4.1. shefi i shtetit, përfshirë cilindo anëtar të organit kolektiv i cili ushtron funksionin e shefit të shtetit sipas kushtetutës së atij shteti;

4.2. Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, çdoherë kur ata gjenden me detyrë jashtë shtetit të tyre, si dhe anëtarët e familjeve të tyre;

4.3. çdo zyrtar i lartë ose përfaqësues i lartë i shtetit ose zyrtari i lartë apo përfaqësuesi tjetër i organizatës ndërkombëtare, i cili në kohën dhe në vendin kur ndaj tij, ndaj lokaleve zyrtare, banesës apo zyrës private ose mjetit transportues i cili ka shenja dalluese është kryer vepër penale, sipas të drejtës ndërkombëtare ka të drejtë në mbrojtje të veçantë nga sulmi ndaj jetës, lirisë dhe dinjitetit të tij.

4.4. Person nën mbrojtje ndërkombëtare përfshinë edhe anëtarët shoqëruar të familjes.

Objekt i kësaj vepre penale, është mbrojtja e jetës personale dhe familjare të personave të cilët janë në misione me karakter ndërkombëtarë si dhe objekteve të tyre me qëllim të funksionalizimit dhe zbatimit normal të funksioneve të tyre diplomatike të karakterit ndërkombëtar.

Sipas vlerësimit të gjykatëse duke u bazuar edhe në ligjin 03/L-033 për statusin , imunitetin dhe privilegjin e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake dhe personelin e sajë neni 3 dhe 5 i këtij ligji, si dhe ligjin 03/L-125 për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të republikës së Kosovës neni 2 të këtij ligji pa kontestueshëm vërtetohet fakti se A.Ç e gëzon statusin e personave nën mbrojtje ndërkombëtare pasi që sipas vetë deklarimit të tij në cilësinë e dëshmitarit si në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të dt:20.11.2021 I verifikuar edhe nga gjykata mban dokument valid të Austrisë me nr. personal:10979396 kopja e të cilit dokument gjendet edhe në shkresat e lëndës, dhe Dekreti i z.A.Ç ref.nr.54/17 i datës:15.02.2017, i lëshuar nga Ministria e Punës së Jashtme të Republikës së Kosovës vërtetohet se i njëjti është shtetas i Austrisë dhe punon si konsull honorar në konsullatën e Austrisë me seli në Pejë.

Gjykata në vlerësim të paragrafit 4 të nenit 167 të KPRK-së ku ka përcaktuar se veprën penale sipas këtij paragrafi e kryen: “Kushdo që bën kanosje serioze se do të kryejë veprë penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.”. Pra, sipas paragrafit 4 konsumohen elementet e veprës penale po qese personi me dashje e me qëllim bën kanosje serioze me qëllim ta privon nga jeta, të kryen rrëmbimin ose sulmin mbi personin apo lirinë e personit nën mbrojtje ndërkombëtare, apo me qëllim që të kryen një sulm të dhunshëm mbi objektet zyrtare, vendbanimin privat ose në mjetet e transportit të një personi nën mbrojtje ndërkombëtare, si dhe kur akti i tillë ka gjasë të rrezikojë personin ose lirinë e tij.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate e duke pas parasysh se dispozita e nenit 167 par.4 të KPRK-së e cila ka paraparë si element qenësorë **kanosjen serioze**, gjykata konstaton se fillimisht për të ekzistuar kanosja serioze duhet që personit të cilit i drejtohet kanosja, t’i bëhet e qartë se çfarë e keqe do godas si dhe që ai person do t’i shkaktojë të keqen, kanosja duhet të jetë serioze, gjegjësisht të jetë objektivisht e tillë që tek i kanosuni të krijohet bindja se do të realizohet, se vërtetë do ta godas ajo e keqe e cila i bëhet me dije. Kanosja duhet të jetë e drejtpërdrejtë e cila do të pasojë menjëherë apo së shpejti, Pasoja e kësaj vepre është shkaktimi i frikës, ankthit apo pasigurisë tek i kanosuni. Vepra penale do të ekzistonte nëse objektivisht ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe ankthit. Kjo veprë fillon me vet shprehjen e kanosjes, ndërsa kryhet kur kanosja objektivisht ka shkaktuar frikë apo ankth tek i kanosuni, andaj për t’u konsideruar kanosja si veprë penale ajo duhet që të jetë: *serioze, e mundshme, dhe e tanishme*. Kanosja është serioze në rastet kur ekziston mundësia reale se e keqja e cila bëhet me dije do të shkaktohet. Se a është kanosja serioze duhet vlerësuar nga këndvështrimi i personit të cilit i është drejtuar kanosja, e jo personit i cili kanoset. Së këndejmi, për ekzistimin e kanosjes është e mjaftueshme që personi të cilit i është drejtuar kanosja ta kuptojë atë si serioze, pa marrë parasysh nëse personi vërtetë ka pas për qëllim ta realizojë kanosjen. Kanosja është e mundshme nëse e keqja që është bërë me dije është realisht e mundshme, që vërtetë mund të realizohet nga personi i cili është kanosë dhe Kanosja konsiderohet e tanishme nëse e keqja mund të realizohet menjëherë, tani apo në një të ardhme të afërt.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, e në referim të përshkrimit faktik të aktakuzës, fjalët që i pandehuri i ka shënuar në mesazhe në gjuhen gjermane të përkthyer në gjuhen shqipe e me të cilat pretendohet se është kanosur i dëmtuari janë shënuar se, citat “*unë do të zhdukë nga faqja e dheut popullin tuaj, nëse ti pretendon me iu kundërvu presidentit, atëherë unë do të ju djegë të gjithëve, Bushtër*”. Pra nga vet përshkrimi faktik i akuzës por edhe nga provat të cilat janë administruar në asnjë rrethanë nuk mund të vërtetohet dhe nuk mund të formohet dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, ngase bazuar në dëshminë e të dëmtuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.11.2021 nder të tjera ka deklaruar se” *personalisht dhe fizikisht nuk është ndier i kërcënuar dhe si përfundim i njëjti ka shtuar se konsullata nuk është e interesuar që ky person të ndiqet penalisht pasi këto institucione nuk ndjen rrezik nga ky person*”, Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale nga neni 167 par. 4 të KPRK-së, ligjvënësi në këtë normë juridike i ka sanksionuar veprimet siç janë *Kushdo që bën kanosje serioze*, pra fillimisht duhet të ekzistojë *kanosja serioze* e mundshme dhe e tanishme, e që në rastin konkretë duke pas parasysh se i dëmtuari bazuar në deklaratën e dhënë nuk e ka ndier dhe nuk ndien veten të kanosur e as të rrezikuar, dhe nga fjalët e të pandehurit nuk i është shkaktuar frikë dhe ankth, si dy elemente bazë në kuptimin subjektiv, si dhe gjithnjë duke u bazuar në deklarinimin e të dëmtuarit se fjalët nuk ka qenë e drejtuar ndaj tij pasi që me të pandehurin nuk janë njohur më parë dhe se i pandehuri ka kontaktuar në numër të telefonit i cili është i tij por në shfrytëzim të konsullatës duke mos e ditur e as njohur personin të cilit i ka shënuar mesazhet me përmbajtjen e lartcekur. Se i pandehuri me të dëmtuarin nuk janë njohur

më herët vërtetohet edhe nga deklaratat e tyre të dhëna në prokurori, ndërsa i akuzuari në deklaratën e tij të dhënë në prokurori ka shprehur pendim dhe keqardhje duke pranuar se mesazhet i ka dërguar por pa e ditur se kujt po ja dërgon këto mesazhe, ka kërkuar falje për të dëmtuarin dhe ka shpreh keqardhje për shqetësimin që i ka bërë, prandaj këto rrethana e bëjnë kanosje jo serioze, duke eliminuar edhe qëllimin për realizimin e sajë.

Gjykata ka vlerësuar edhe përmbajtjen e mesazheve të cilat i pandehuri në gjuhën gjermane i ka dërguar duke shënuar se” *“Unë do ta zhduk nga faqja e dheut popullin tuaj, nëse ti pretendon me iu kundërvu Presidentit, atëherë unë do të ju djeg të gjithëve, Bushtër”*. andaj duke pas parasysh se është kërkesë e dispozitës ligjore të nenit 167 par.4 të KPRK-së, kanosja duhet të jetë e mundshme ashtu që nëse e keqja që është bërë me dije është realisht e mundshme, që vërtetë mund të realizohet nga personi i cili është kanosë, ndërsa vlerësuar nga përmbajtja e mesazhit shihet qartë se kanosja e pretenduar nuk është e mundur, nuk i është drejtuar të dëmtuarit ashtu që i pandehuri është deklaruar se është president i Austrisë e që në fakt nuk është president, por qytetar i Kosovës, dhe se ka deklaruar se do ta zhduk nga faqja e dheut popullin tuaj pra kanosja i është drejtuar në drejtim të popullit e jo të dëmtuarit për çka edhe gjykata konstaton se realizimi i kanosjes si në rastin konkret është e pa mundur.

Në aktakuzës PPS.nr.28/2019 të dt.29.07.2020 është pretenduar se:

I akuzuari A.P me dt..... në ora 01:26 min në P...me qëllim të frikësimit serioz i është kanosur të dëmtuarit-zyrtarit të konsullatës në Konsullin e Austrisë në P. A. Ç. në atë mënyrë që pasi paraprakisht me dt..... në ora 13:41 i pandehuri përmes numrit të telefonit të tij mobil i dërgon SMS të dëmtuarit A.Ç. në numrin e tij të telefonit në gjuhën Gj.. duke i kërkuar nga i njëjti që t’ia siguroj një dokument udhëtimi dhe mjete materiale me qëllim të udhëtimit në Austri dhe pasi që i dëmtuari nuk është përgjigj në telefon në natën kritike i pandehuri përmes aplikacionit Whats App në gjuhën Gjermane i dërgon një SMS me përmbajtje kërcënuese *“unë do të zhdukë nga faqja e dheut popullin tuaj nëse ti pretendon me iu kundërvu presidentit atëherë unë do të ju djegë të gjithëve bushtër.*

Për gjykatën nuk është kontestuese se i akuzuari A.P ditën kritike fillimisht të ketë biseduar me të dëmtuarin përmes telefonit dhe po ashtu nuk është kontestuese se me datë të dëmtuarit A.Ç.në numrin e tij të telefonit ...në ora 01:26 min në gjuhën Gjermane në përmes aplikacionit Whats App në gjuhën Gjermane i dërgon një SMS me përmbajtje *“unë do të zhdukë nga faqja e dheut popullin tuaj nëse ti pretendon me iu kundërvu presidentit atëherë unë do të ju djegë të gjithëve bushtër.*, fakt ky që vërtetohet nga dëshmia e të dëmtuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me dt:... si dhe provat materiale si Mesazhet e përkthyer në gjuhën Shqipe të datës ... dhe ... të nxjerra nga telefoni i të dëmtuarit A.Ç të cilat mesazhe në aplikacionin “Whatsapp” në numrin e tij të telefonit i kishte pranuar nga tani i akuzuari A.P, I cili me rastin e deklaramit për fajësinë ka pohuar se i ka dërguar sms-in me përmbajtjen e sipër cekur, por në atë moment ka qenë nën ndikim të alkoolit, ndërsa fakti se i akuzuari ka qenë jo stabil dhe i pa qartë në komunikim me të dëmtuarin vërtetohet edhe nga dëshmia e të dëmtuarit ku ka theksuar se” *kam ardhë në përfundim se ky nuk më ka njohur dhe nuk e ka ditë me kanë fletë, e po ashtu kam ndi keqardhje për gjendjen e tij shpirtërore, dhe fli tej për gjendjen e tij shpirtërore dhe shëndetësore sepse edhe atë ditë ka qenë në ndikim të ndonjë alkooli apo substance tjetër dhe ky është mendimi i imë personal”*fakt ky i cili vërtetohet edhe nga mendimi i ekspertit psikiatër i cili në ekspertizë ka konstatuar se i akuzuari si pasoj e sjelljes i përdorimit të substancave psiko-aktive, çrregullim ky që kodohet me F19 dhe çrregullimi i personalitetin i pa specifikuar, në momentin e kryerje së veprës për të cilën akuzohet i ekzaminuari ynë nuk ka qanë në gjendje të intoksikimit akut, apo abstinencës kështu që *aftësia për të kuptuar veprime te vetë ka qenë zvogëluar por jo esancialisht.*

Andaj nga këto arsye gjykata ka vlerësuar edhe aspektin sa i përket formës së fajit, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase, për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm qëllimi të pandehurit që të dëmtuarit ti shkaktoj frikë dhe ankth, është me rëndësi relevante për ndërtimin e figurës së veprës penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, e që në rastin konkret jo vetëm që nuk është përfshirë në përkrahje të veprimeve inkriminuese në dispozitivë të aktakuzës, por as edhe pas administrimit të provave personale dhe materiale në shqyrtim gjyqësor, nuk u vërtetua një gjendje e tillë faktike në referim të qëllimit të shkakimit të kanosjes serioze ndaj të dëmtuarit për faktin se vetë i dëmtuari ka deklaruar në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor se *“personalisht nuk ndjej ndonjë rrezik, nga ky person pasi tani ja njoh edhe familjen dhe ky i takon një familjes të ndershme, konsideroj se nuk ka asnjë rrezik nga ky”*, andaj në mënyrë që të ndodhemi përpara veprës penale Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, ashtu siç është shprehur edhe në fillim të analizës së saj kjo gjykatë, duhet të jetë kryer nga ana e të pandehurit me dashje direkte, përveç elementëve që duhet të ketë në vetvete, pra të jetë në kundërshtim me ligjin dhe të ketë sjellë si pasojë të ketë shkaktuar rrezik dhe kanosje serioze për të dëmtuarin duke shkaktuar ankth dhe frikë e pasiguri për jetë, e që në rastin konkret nuk është arrite.

Në ndryshim me çka është pretenduar nga organi i akuzës në gjykim, kjo gjykatë vëren se jo çdo veprim përben edhe vepër penale e që në rastin konkret duke pas parasysh se kanosja e drejtuar përmes sms-it në drejtim të numrit të telefonit për të cilin i pandehuri nuk e ka ditur se kush është pronari e as poseduesi, si dhe i dëmtuari ka deklaruar se fare nuk është frikuar e as që ka dashur që të filloj procedure, por se kjo çështje ka filluar nga organet e sigurisë së konsullatës, por pasi që e kanë kuptuar se nga kush ka ardhë SMS-i, në pajtim edhe me organet e sigurisë së konsullatës nuk e ndjejnë ndonjë rrezik, nuk ndihet i kanosur si dhe nuk ka kërkesa pasurore, I ka propozuar gjykatës që të mos ndiqet akuzuari penalisht por ndaj tij të shikohet mundësia për trajtim eventual mjekësor sipas rekomandimeve të eksperteve, andaj nga këto deklarime të të dëmtuarit gjykata konstaton se nuk ka ekzistuar rrezik serioz as për të dëmtuarin e as për konsullatën e Austrisë në Pejë ashtu që nga ky deklarim konstatohet se nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilat i pandehuri është akuzuar.

Në mënyrë që të konkludohet në një vendim fajësie, gjykata, në përfundim të gjykimit nuk duhet të ketë mëdyshje për mundësinë e kryerjes së veprës nga i pandehuri, në të kundërt, çdo dyshim çmohet në favor të tij.

Gjykata ka vlerësuar propozimin e prokurorisë të dhënë në fjalën përfundimtare që ndaj të akuzuarit si dënim plotësues të njëjti ti shqiptoj masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri për aq kohë sa gjykata mendon, për shkak se ekziston rreziku se i njëjti mund të përsëritë ndonjë vepër tjetër penale.

Gjykata sjell në vëmendje se masa e trajtimit të detyrueshëm në liri nuk bënë pjesë në grupin e dënimeve plotësuese siç është paraparë në nenin 59 të KPRK-së por janë lloj i veçanta i masave të cilët mund të ju shqiptohen kryesisht i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore siç është paraparë në nenin 86 të KPRK-së, sipas këtij neni decidivisht është përcaktuar se *“Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri kryesisht i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore...”* pra sipas kësaj dispozite masa trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri mund ti shqiptohet vetëm kryesisht i cili ka kryer vepër penale, pra është vërtetuar fajësia e tij, në rastin konkret gjykata nuk ka mundur ta vërtetojë fajësinë e të pandehurit prandaj edhe e ka liruar nga akuza, dhe rrjedhimisht nuk mund ti shqiptoj ndonjë sanksion apo masë pa u vërtetuar fajësia e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Propozimi i PSRK-së nuk gjen mbështetje as në provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor siç janë Raporti i ekspertizës nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me numër të protokollit ... i datës:....., për ekzaminim psikiatrik të tani të akuzuarit A.P, si dhe deklarimi I ekspertit Dr J. Z. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dt:... I cili ka deklaruar se” *ne si ekip vlerësuese duke u bazuar në të dhënat e heteroanestike, shikimin e dokumentacionit që gjendet në shkresat e lëndës, ekzaminimin ambulator, analiza e rasteve të ngjashme dhe konsultimi i literaturës në bazë të këtyre të dhënave kemi ardhë në përfundim se i ekzaminuari ynë vuan nga çrregullim mendor dhe çrregullimi i sjelljes i përdorimit të substancave psiko-aktive, çrregullim ky që kodohet me F19 dhe çrregullimi i personalitetin i pa specifikuar, në momentin e kryerje së veprës për të cilën akuzohet i ekzaminuari ynë nuk ka qanë në gjendje të intoksikimit akut, apo abstinencës kështu që aftësia për të kuptuar veprime te vetë ka qenë zvogëluar por jo esencialisht, që do të thotë se i njëjti ka qenë përgjegjës për veprimet që i ka marr ne jemi bazuar edhe në trajtimin e mëhershëm që i njëjti ka qenë në institucion e psikiatrisë forenzikës për trajtim, sipas këtij konstatimi aftësia e të akuzuarit për të kuptuar veprime te vetë ka qenë zvogëluar por jo esencialisht dhe se I njëjti ka qenë në gjendje për ti kuptuar veprimet e tij, ndërsa sa i përket trajtimit të rastit konkret eksperti ka shtuar se *ne nuk kemi kërkuar ndonjë masë të trajtimit pasi që kemi vlerësuar se i njëjti është përgjegjës për veprimet e tij, mirëpo në paragrafin e fundit të ekspertizës ne kemi sugjeruar dhe orientuar që i njëjti ka nevojë të trajtohet dhe ky trajtim duke pas parasysh se i njëjti ka probleme sa i përket përdorimit të substancave është në vullnetin e tij që dëshiron të trajtohet apo nuk dëshiron ne edhe për këtë arsye ne kemi sugjeruar që i njëjti te ketë trajtim medikamentoz simptomatik, në bazë të simptomave dhe rehabilitim psike-social me qëllim të motivimit në drejtim të ndërprerjes së abuzimit me substancën andaj ketë trajtim mund ta merr në mënyrë të ndryshme, nuk e kemi kërkuar ndonjë masë, andaj gjykata bazuar në raportin e ekspertizës ashtu edhe nga deklarimi I Ekspertit psikiatër konstaton se ndaj të pandehurit nuk është kërkuar dhe nuk është e nevojshme të i caktohet masa trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri.**

Sa i përket rrezikut për përsëritjen veprave eksperti ka deklaruar” mendoj që i njëjti duhet të ketë konsulta me mjeket psikiatër në mënyrë që rreziku të jetë më i vogël për përsëritje e veprave të tilla, nëse ai përmbahet këshillave mjekësore dhe i njëjti e ndërpre në abuzimin me substanca psikoaktive rreziku duhet të jetë më i ulët për përsëritjen e veprave të tilla. Sa i përket përdorimit të substancave personat në fjalë dhe personat tjetra kanë njohuri të mjaftueshme për përdorimin e këtyre substancave, dhe mund të gjykohen për e këto vepra që bien ndesh me ligjin, nga ky mendim gjykata konstaton se i akuzuari me vullnetin e tij duhet të ketë konsulta me mjekë psikiatër dhe të trajtohet në mënyrë që rreziku të jetë më vogël për sjellje eventuale kundërligjore, në të kundërtën nëse veprimet e tij bie ndesh me ligjin i njëjti mund të ndiqet penalisht për vepër të re penale.

Andaj gjykata mbi arsyet e sipër cekura gjen se propozimi I PSRK-së për shqiptimin e masës trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri nuk gjen mbështetje në provat dhe faktet e administruara dhe të vërtetuara në këtë gjykim si dhe nuk gjen as mbështetje ligjore, dhe si I tillë është I pa bazuar.

Nga sa është arsyetuar më lart, Gjykata arrin në përfundim se nuk është provuar se I pandehuri e ka kryer e veprën penale të “Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare nga neni 167 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së”.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike.

I dëmtuari ka heq dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti Special
PS.nr.32/20, të dt: 09.12.2021

Zyrtare për Bashkëpunim profesional.
Luljeta Gashi

Kryetari i trupit gjyqësor,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.